

LIGJ
Nr.8436, datë 28.12.1998

PËR ORGANIZIMIN E PUSHTETIT GJYQËSOR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

(Ndryshuar me Ligjin nr. 8546, datë 5.11.1999; Vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 59, datë 5.11.1999; ligjin nr. 8656, datë 31.7.2000; nr. 8811, datë 17.5.2001)
(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 81 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
PUSHTETI GJYQËSOR

Neni 1

Pushteti gjyqësor ushtrohet vetëm nga gjykatat, në përputhje me Kushtetutën dhe kompetencat e ngarkuara me ligj.

Neni 2

Gjykatat kanë kompetencë të shqyrtojnë të gjitha çështjet penale, penale ushtarake, civile, administrative, si dhe çdo çështje tjetër të përcaktuar në ligj.

Neni 3

Gjyqtarët, në ushtrimin e funksionit të tyre janë të pavarur dhe i nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve.

Neni 4

Prokurorët janë të organizuar dhe funksionojnë pranë sistemit gjyqësor në të gjitha shkallët e tij si një organ i centralizuar.

Organizimi e funksionimi i prokurorisë, si dhe i avokatisë rregullohen me ligje të veçanta.

Neni 4/a

Viti gjyqësor

(Shtuar me ligjin nr. 8656, datë 31.7.2000)

1. Viti gjyqësor fillon më datën 10 maj të çdo viti kalendarik dhe përfundon më datën 9 maj të vitit pasardhës.

2. Ceremonia e përvitshmërisë të vitit të ri gjyqësor bëhet në formë publike dhe solemne. Në këtë ceremoni marrin pjesë gjyqtarë, prokurorë, funksionarë të Ministrisë së Drejtësisë, të ftuar

nga Gjykata Kushtetuese, Zyra e Avokatit të Popullit, Dhoma Kombëtare e Avokatisë, Dhoma Kombëtare e Noterisë, si dhe nga institucione ose subjekte të tjera, veprimtaria e të cilëve lidhet me fushën e drejtësisë dhe gjyqësorit.

3. Ditën e përrurimit të vitit të ri gjyqësor, Kryetari i Gjykatës së Lartë, Prokurori i Përgjithshëm dhe Ministri i Drejtësisë bëjnë publike Rezolutën e Përbashkët, lidhur me administrimin dhe problemet në fushën e drejtësisë në Republikën e Shqipërisë, në të cilën, ndër të tjera, jepen edhe orientime dhe rekomandime për veprimtarinë në vitin e ri gjyqësor.

4. Kopje e Rezolutës së Përbashkët, lidhur me administrimin dhe problemet në fushën e drejtësisë, i dërgohet Presidentit të Republikës, Kuvendit dhe Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë.

KREU II ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I GJYKATAVE

Neni 5

(Ndryshuar fjalë me Ligjin nr. 8546, datë 5.11.1999)

Sistemi gjyqësor përbëhet nga gjykatat e shkallës së parë, gjykatat e apelit dhe Gjykata e Lartë.

Neni 6

(Shtuar paragrafi i parë me ligjin nr. 8656, datë 31.7.2000)

Gjykata të shkallës së parë janë gjykatat e rretheve gjyqësore, gjykatat e krimeve të rënda dhe gjykatat ushtarake.

Gjykatat e shkallës së parë gjykojnë sipas rregullave të parashikuara në kodet e procedurave, ku përcaktohet edhe përbërja e trupit gjykues.

Neni 7

(Ndryshuar me ligjin nr. 8656, datë 31.7.2000)

Gjykatat e apelit gjykojnë në shkallë të dytë, me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë, ankimet kundër vendimeve të gjykatave të rretheve gjyqësore.

Gjykatat e apelit gjykojnë në shkallë të dytë, me trup gjykues të përbërë nga pesë gjyqtarë, ankimet kundër vendimeve të gjykatave për krimet e rënda.

Neni 8

Gjykatat ushtarake organizohen dhe funksionojnë brenda sistemit gjyqësor sipas kompetencave të përcaktuara me ligj.

Neni 9

Gjykatat ushtarake përbëhen nga gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit.

Neni 10

(Shtuar fjalia e fundit me ligjin nr. 8656, datë 31.7.2000)

Gjykata ushtarake e apelit shqyrtohen në shkallë të dytë ankimet kundër vendimeve të

gjykatave ushtarake të shkallës së parë. Ajo gjykon me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë. Krimet e rënda gjykohen nga pesë gjyqtarë.

Neni 11

(Ndryshuar togfjalësh dhe shtuar fjalia e dytë me ligjin nr. 8656, datë 31.7.2000)

Gjykatat e rretheve gjyqësore organizohen dhe funksionojnë në rrethe gjyqësore në të gjithë territorin e vendit. Gjykatat për krimet e rënda organizohen dhe funksionojnë në një a më shumë rrethe gjyqësore. Kompetencat tokësore dhe qendra e ushtrimit të veprimtarisë për secilën prej tyre caktohet me dekret të Presidentit të Republikës, me propozim të ministrit të Drejtësisë, pasi të jetë marrë edhe mendimi i Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Gjykatat e apelit funksionojnë në zona të caktuara nga Presidenti i Republikës, me propozim të ministrit të Drejtësisë, pasi të jetë marrë edhe mendimi i Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Me ligj mund të krijohen edhe gjykata të shkallës së parë apo të apelit për fusha të veçanta.

Neni 12

Numri i përgjithshëm i gjyqtarëve të të gjitha hallkave gjyqësore caktohet me dekret të Presidentit të Republikës, me propozim të ministrit të Drejtësisë, pasi të jetë marrë edhe mendimi i Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Neni 13

Gjykata e Lartë është autoriteti më i lartë gjyqësor, i cili ka juridiksion fillestar dhe rishikues.

Gjykata e Lartë e ka qendrën në Tiranë.

Organizimi dhe funksionet e Gjykatës së Lartë përcaktohen me ligj të veçantë të bazuar në Kushtetutë.

Neni 14

(Shfuqizuar paragrafi I fundit me Ligjin nr. 8546, datë 5.11.1999)

Në fillim të çdo viti, kryetari i gjykatës së apelit dhe kryetari i gjykatës së shkallës së parë, përcaktojnë për vitin në vazhdim shpërndarjen e gjyqtarëve në dhoma penale e civile të gjykatës.

Në dhomën e çështjeve civile përfshihen edhe gjyqtarët e seksioneve për gjykimet e posaçme.

Kur madhësia e gjykatës nuk lejon të organizohen të paktën një dhomë civile dhe një dhomë penale, ndarja e çështjeve bëhet midis të gjithë gjyqtarëve në mënyrë të barabartë.

Neni 14/a

(Shtuar me Ligjin nr. 8546, datë 5.11.1999)

1. Shërbimet ndihmëse në gjykatë drejtohen nga Kancelari dhe përmbushen nga sekretaria gjyqësore, degët dhe sektorët e administratës, të ekonomisë, financës, informatizimit, regjistrimit dhe ruajtjes së dokumenteve.

2. Përcaktimi i sektorëve dhe organikave për çdo gjykatë bëhet me urdhër të Ministrit të Drejtësisë.

Neni 14/b

(Shtuar me Ligjin nr. 8546, datë 5.11.1999; shtuar fjalë e dytë në pikën 2 me ligjin nr. 8656, datë 31.7.2000)

1. Kancelari emërohet dhe shkarkohet nga Ministri i Drejtësisë.
2. Kancelar emërohet personi i cili është diplomuar jurist dhe që ka një përvojë pune në këtë profesion prej jo më pak se pesë vjet. Kancelari përfiton pagë dhe leje të pagueshme vjetore të njëjtë me atë të gjyqtarit të gjykatës përkatëse ku ushtron funksionet e tij.
3. Emërimi dhe shkarkimi i sekretarëve gjyqësorë dhe i personelit administrativo-teknik të shërbimeve të gjykatës bëhet nga Kryetari i Gjykatës, me propozim të Kancelarit.
4. Kryetari i degës së buxhetit në gjykatë emërohet dhe shkarkohet nga Ministri i Drejtësisë.

Neni 15

Ndarja e çështjeve gjyqësore në të gjitha hallkat e sistemit gjyqësor bëhet me short sipas procedurave të përcaktuara me ligj.

Neni 16

Vendimet gjyqësore mund të jenë objekt shqyrtimi vetëm mbi bazën e ankimeve ose rekurseve në rrugë gjyqësore, sipas përcaktimeve në kodet e procedurave ose në ligje të veçanta.

Neni 17

(Shtuar paragraf dhe ndryshuar paragrafi I dytë me Ligjin nr. 8546, datë 5.11.1999; shtuar togfjalësh në paragrafin e dytë me ligjin nr. 8656, datë 31.7.2000; shfuqizuar me ligjin nr. 8811, datë 17.5.2001)

Neni 18

(Shfuqizuar paragrafi I dytë me ligjin nr. 8811, datë 17.5.2001)

Pushteti gjyqësor ka buxhet të veçantë, i cili administrohet prej tij sipas përcaktimeve të parashikuara në ligj të veçantë.

KREU III

KUSHTET PËR T'U PRANUAR GJYQTAR I GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË DHE TË APELIT

Neni 19

Gjyqtarë mund të emërohen shtetasit shqiptarë që përmbushin kriteret e mëposhtme:

1. Të kenë zotësi të plotë për të vepruar.
2. Të jenë me arsim të lartë juridik.
3. Të kenë përfunduar Shkollën e Magjistraturës.
4. Të mos kenë qenë të dënuar ndonjëherë dhe të gëzojnë reputacion të mirë.
5. Të jenë jo më pak se 25 vjeç.

Neni 20

(Ndryshuar paragrafi I parë dhe shtuar paragrafi i fundit me Ligjin nr. 8546, datë 5.11.1999; shfuqizuar paragrafi I shtatë me ligjin nr. 8811, datë 17.5.2001)

Mund të emërohen si gjyqtarë edhe personat që nuk kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës, në qoftë se përmbushin kriteret e nenit 19 të këtij ligji dhe njërin prej kriterëve të mëposhtme:

1. Kanë punuar për mbi tre vjet si pedagogë në Fakultetin e Drejtësisë ose në Shkollën e Magjistraturës, deputet, këshilltarë ligjorë në Kuvend, pranë Presidentit ose në Këshillin e Ministrave, ose specialistë në Ministrinë e Drejtësisë, në Gjykatën e Lartë apo në Prokurorinë e Përgjithshme.

2. Kanë marrë një diplomë nga një program kualifikimi afatgjatë pasuniversitar juridik jashtë shtetit, që përmbush kërkesat e legjislacionit shqiptar ose të marrëveshjeve ndërkombëtare.

3. Kanë punuar për pesë ose më shumë vjet si gjyqtarë, ndihmës gjyqtarë, prokurorë, avokatë ose noterë dhe kanë kaluar një provim kualifikimi profesional të organizuar sipas këtij neni.

Personat që emërohen gjyqtarë sipas pikës 3 do t'i nënshtrohen një provimi të detyrueshëm teorik dhe praktik, me shkrim e me gojë, brenda 6 muajve nga dita e emërimit. Provimi do të organizohet nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës dhe Fakultetin Juridik të Universitetit të Tiranës.

3/a. Për emërimin si gjyqtarë të ndihmësgjyqtarëve që punojnë aktualisht nëpër gjykatat e shkallës së parë, afati i përcaktuar në pikën 3 të këtij neni nuk është kriter i detyrueshëm.

Neni 20/a

(Shtuar me Ligjin nr. 8546, datë 5.11.1999)

1. Me propozim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Presidenti i Republikës emëron gjyqtarë personat që kanë mbaruar vitin e dytë të Shkollës së Magjistraturës për të kryer stazhin profesional të parashikuar në ligjin nr.8136, datë 31.7.1996 “Për shkollën e Magjistraturës së Republikës të Shqipërisë”, në gjykatat që kanë kushtet më të mira për organizimin e këtij stazhi.

2. Kriteret e përcaktuara në pikat 3 dhe 5 të nenit 19 të këtij ligji nuk përbëjnë pengesë vetëm për emërimin e personave të përmendur në pikën 1 të këtij neni.

3. Pas përfundimit të stazhit profesional, Presidenti i Republikës dekreton caktimin e tyre në gjykatat e rretheve gjyqësore, sipas nevojave që ato kanë.

Neni 21

Vendet e paplotësuara për gjyqtarë duhet të shpallen nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

Neni 22

(Ndryshuar paragrafi i parë me Ligjin nr. 8546, datë 5.11.1999; shfuqizuar me ligjin nr. 8811, datë 17.5.2001)

Neni 23

Para fillimit të detyrës, gjyqtarët bëjnë betimin si më poshtë:

“Betohe më solemnisht se gjatë kryerjes së detyrës do t'i qëndroj kurdohërë besnik Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, ligjeve në fuqi dhe do të respektoj rregullat e

etikës profesionale”.

Betimi i gjyqtarëve të porsaemëruar bëhet para gjyqtarëve të instancës ku janë caktuar për të kryer detyrën.

Neni 24

(Ndryshuar me Ligjin nr. 8546, datë 5.11.1999; ndryshuar togfjalësh në pikën 1 me ligjin nr. 8656, datë 31.7.2000; shfuqizuar paragrafi i dytë me ligjin nr. 8811, datë 17.5.2001)

1. Gjyqtarët e gjykatave për krimet e rënda dhe të gjykatave të apelit emërohen nga Presidenti i Republikës me propozim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, mbi bazën e konkurrimit, pasi të kenë punuar jo më pak se pesë vjet në gjykatat e shkallës së parë dhe të jenë dalluar për aftësi profesionale dhe cilësi të larta etiko-morale.

2. Shfuqizuar.

Neni 25

Gjyqtarët mund të qëndrojnë në detyrë deri në moshën 65 vjeç.

Neni 25/1

(Shtuar me ligjin nr. 8656, datë 31.7.2000)

Për plotësimin e vendeve vakante dhe emërimin në detyrë të specialistëve psikologë, që bëjnë pjesë në trupat gjykues për gjykimin e të miturve, zbatohen procedurat e parashikuara në nenet 21, 22 dhe 23 të këtij ligji.

Specialisti psikolog përfiton 80 për qind të pagës së gjyqtarit të gjykatës së rrethit gjyqësor ku ushtron funksionet e tij, si dhe leje të pagueshme vjetore prej 30 ditësh.

KREU IV STATUSI I GJYQTARËVE

Neni 26

Gjyqtarët gëzojnë imunitet.

Gjyqtarët e shkallës së parë dhe të apelit mund të ndiqen penalisht vetëm me miratim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Gjyqtari mund të ndalohet ose të arrestohet vetëm në qoftë se kapet në kryerje e sipër të një krimi ose menjëherë pas kryerjes së tij. Organi kompetent njofton menjëherë Këshillin e Lartë të Drejtësisë. Në qoftë se Këshilli i Lartë i Drejtësisë nuk jep pëlqimin brenda 24 orëve për dërgimin në gjykatë të gjyqtarit të arrestuar, organi kompetent është i detyruar ta lirojë atë.

Neni 27

Gjyqtarët nuk mund të lëvizin nga detyra, përveç kur:

1. japin dorëheqjen;
2. mbushin moshën për pension;
3. dënohen penalisht me anë të një vendimi të formës së prerë të gjykatës;
4. konkludohet se ata janë fizikisht ose mendërisht të paaftë ose, sipas kriterëve të përcaktuara në nenet 45 ose 48 të këtij ligji, konkludohet pamjaftueshmëria e tyre profesionale;
5. merren ndaj tyre masa disiplinore nga organi kompetent sipas rasteve të parashikuara

nga ligji;

6. kryejnë veprime apo mbajnë funksione që bien ndesh me nenet 29 deri 35 të këtij ligji.

Në rastin kur ndaj një gjyqtari vendoset fillimi i një çështjeje penale, ai pezullohet nga detyra derisa të merret vendim i formës së prerë.

Në rastet kur fajësia nuk provohet me vendim të formës së prerë të gjykatës, gjyqtari ka të drejtë të kthehet në punën e tij /saj të mëparshme dhe të marrë pagën e plotë që nga koha e pezullimit.

Neni 28

(Shtuar paragrafi i fundit me Ligjin nr. 8546, datë 5.11.1999; shfuqizuar paragrafi i pestë me ligjin nr. 8811, datë 17.5.2001)

Ngritja në përgjegjësi dhe transferimi i gjyqtarit nga puna e tij bëhet vetëm me pëlqimin e tij/saj, përveç rasteve të parashikuara nga ky ligj.

Në rast se një gjykatë nuk funksionon normalisht për shkak të mungesës së përkohshme të gjyqtarëve ose për shkak të mbingarkesës së punës, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, i delegon gjyqtarët nga një gjykatë në një tjetër për një periudhë prej jo më shumë se 3 muaj në vit edhe pa pëlqimin e gjyqtarit.

Në fund të këtij afati, gjyqtari shkon përsëri në vendin e tij të mëparshëm.

Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, mund të emërojë një gjyqtar të gjykojë një numër çështjesh në një gjykatë tjetër të të njëjtit nivel, nëse mungojnë gjyqtarët në këtë gjykatë.

Neni 29

Gjyqtarëve u ndalohet të bëjnë pjesë në parti politike ose të marrin pjesë në veprimtari me karakter politik.

Neni 30

Funksioni i gjyqtarit është i papajtueshëm me çdo mandat zgjedhor, si dhe me çdo funksion dhe veprimtari tjetër publike ose private.

Gjyqtarëve u ndalohet të marrin pjesë në administrimin apo drejtimin e shoqërive civile ose tregtare, personalisht ose me anë përfaqësimi.

Neni 30/a

(Shtuar me ligjin nr. 8656, datë 31.7.2000)

Gjyqtarët mund të shërbejnë në nivele drejtuese të kabinetit të Ministrit dhe strukturave juridiko-profesionale të Ministrisë së Drejtësisë. Periudha e shërbimit civil të tyre në këto struktura njihet periudhë vjetërsie në punë si gjyqtar për efekt të kërkesave të karrierës profesionale, të parashikuara në dispozitat e ligjeve për organizimin e pushtetit gjyqësor, Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese dhe të Prokurorisë.

Gjyqtarët që shërbejnë si nëpunës civilë në Ministrinë e Drejtësisë, me kërkesë të tyre, riemërohen gjyqtarë pa konkurs.

Neni 31

Gjyqtarët nuk mund të jenë ekspertë ose arbitër të palëve në arbitrazh.

Neni 32

Gjyqtarit i ndalohet të bëjë deklaratë në lidhje me proceset, të bëjë të ditur mendimet që janë dhënë gjatë seancave të gjykimit, që akoma nuk kanë marrë formën e një vendimi, të deklarojë përmbajtjen e akteve ose dokumenteve zyrtare me karakter sekret ose vetjak.

Neni 33

(Ndryshuar me Ligjin nr. 8546, datë 5.11.1999)

Gjatë gjykimit të çështjeve gjyqtarët, prokurorët dhe avokatët duhet të respektojnë solemnitetin e gjykimit dhe të mbajnë veshje të posaçme. Rregullat në lidhje me solemnitetin e gjykimit dhe veshjen përcaktohen me urdhër të Ministrit të Drejtësisë, pasi të ketë marrë mendimin e Kryetarit të Gjykatës së Lartë, të Prokurorit të Përgjithshëm dhe Dhomës Kombëtare të Avokatëve.

Neni 34

Gjyqtarët duhet të ruajnë dinjitetin e tyre, duke mos lejuar veprime që kompromentojnë profesionin, organet e drejtësisë dhe figurën e tyre në shoqëri.

Neni 35

Gjyqtarët janë të lirë të krijojnë shoqata ose organizata për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e tyre, si dhe për ngritjen profesionale.

Gjyqtarëve u ndalohet të bëjnë greva.

Neni 36

Për të garantuar rendin dhe sigurinë, pranë gjykatave organizohet shërbimi i vazhdueshëm i policisë, i cili vepron sipas urdhrave të autoriteteve gjyqësore.

Neni 37

Asnjë gjyqtar nuk përgjigjet në një padi civile, e cila lidhet me kryerjen e detyrave të tij profesionale, me përjashtim të rasteve kur parashikohet shprehimisht me një ligj të veçantë.

Neni 38

Gjyqtarët kanë të drejtë:

1. Të kenë një mbrojtje të veçantë të vetes, familjes dhe pronës, kur një gjë të tillë e kërkojnë vetë për rrethana serioze ose çmohet se është e domosdoshme.
2. Të përfitojnë falas fletoret zyrtare, gazetat dhe revistat juridike.

Neni 38/a

(Shtuar me ligjin nr. 8656, datë 31.7.2000)

Ruajtja e veçantë vetjake për familjen dhe pronën e gjyqtarëve të gjykatave për krimet e rënda, si dhe trajtimi financiar i posaçëm i tyre, rregullohen me ligj.

Neni 39

Gjyqtarët përfitojnë leje të pagueshme vjetore prej 30 ditësh. Leja vjetore bëhet në muajt korrik dhe gusht.

Gjyqtarët e ngarkuar me kryerjen e detyrave të ngutëshme për periudhën korrik-gusht, lejen vjetore e bëjnë në një periudhë tjetër, duke përfituar 5 ditë shtesë.

KREU V PËRGJEGJËSIA DISIPLINORE E GJYQTARËVE

Neni 40

Gjyqtarët kanë përgjegjësi për shkeljet e disiplinës, si dhe për kryerjen e akteve e të sjelljeve që diskretitojnë rëndë figurën e tyre dhe autoritetin e drejtësisë.

Neni 41

Konsiderohen shkelje të disiplinës:

1. Kryerja e veprimeve që sipas ligjit janë të papajtueshme me funksionin e gjyqtarit.
2. Nxjerrja e sekretit të hetimit, të dhomës së këshillimit ose të të dhënave të tjera me karakter intim.
3. Zvarritje të rënda ose sistematike në kryerjen e detyrës.
4. Mosrespektimi i rregullave të solemnitetit.
5. Mungesat pa arsye në punë.
6. Kryerja e veprimeve të pahijshme ose amorale brenda dhe jashtë kohës së punës.
7. Kryerja e veprimeve në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës ose moskryerja e veprimeve të detyrueshme proceduriale, kur nuk përbën vepër penale.
8. Moszbatimi pa arsye i masës së dhënë disiplinore.

Neni 42

(Shfuqizuar pika 3 dhe ndryshuar pika 5 me Ligjin nr. 8546, datë 5.11.1999)

Për shkelje të disiplinës, si dhe akte e sjellje të tjera diskretituese, merren këto masa:

1. Vërejtje.
2. Vërejtje me paralajmërim.
3. Shfuqizuar.
4. Pezullim nga detyra dhe kalim në një detyrë tjetër më të ulët brenda gjykatës për një periudhë nga gjashtë muaj deri në një vit.
5. Transferimin në një gjykatë tjetër të të njëjtit nivel ose të një niveli më të ulët.
6. Shkarkim nga detyra.

Neni 43

Masat disiplinore ndaj gjyqtarëve merren nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë në bazë të vlerësimit të llojit dhe të karakterit të shkeljes së kryer.

Neni 44

(Shfuqizuar paragrafi i gjashtë me ligjin nr. 8811, datë 17.5.2001)

Procedimi disiplinor për gjyqtarët vihet në lëvizje nga ministri i Drejtësisë.

Fillimi i procedimit disiplinor mund të bëhet brenda tre vjetëve nga data e kryerjes së shkeljes.

Gjatë verifikimit, që bëhet nga inspektorët, përcaktohet nëse është kryer ndonjë shkelje e disiplinës nga ato të përcaktuara në ligj, lloji dhe rëndësia e shkeljes, fajësia e personit, si dhe të dhëna mbi të cilat mbështeten përfundimet e nxjerra.

Në çdo rast duhet të dëgjohet edhe gjyqtari që ka kryer shkeljen. Verifikimi i pretendimeve është i detyrueshëm.

Rezultatet e verifikimeve të bëra, si dhe të dhënat shkresore rreth tyre, pasqyrohen në një akt përfundimtar, i cili i bëhet i njohur gjyqtarit që ka kryer shkeljen.

Këshilli i Lartë i Drejtësisë, përpara se të marrë vendimin, duhet të dëgjojë në një seancë pretendimet e palëve. Materialet e plota i vihen në dispozicion gjyqtarit 10 ditë përpara zhvillimit të seancës. Ai ka të drejtë të mbrohet vetë ose me avokatë gjatë seancës.

Neni 45

(Shfuqizuar paragrafi i tretë me ligjin nr. 8811, datë 17.5.2001)

Këshilli i Lartë i Drejtësisë jo më vonë se një herë në dy vjet bën vlerësimin e aftësive profesionale të gjyqtarëve, bazuar mbi cilësinë, volumin e punës, shpejtësinë e gjykimit, reputacionin dhe botimin e punimeve juridike, si më poshtë:

1. Shumë mirë
2. Mirë
3. Pranueshëm
4. I paaftë

Inspektori i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, që ka përgatitur projekt-aktin e vlerësimit të aftësive profesionale, ia komunikon atë gjyqtarit përkatës paraprakisht, dhe ky i fundit ka të drejtën të paraqesë kundërshtimet e tij brenda një afati prej 8 ditësh.

Vlerësimi “i paaftë” përbën shkak për shkarkimin nga puna.

Neni 46

Gjyqtari kur shkarkohet nga detyra për një nga arsyet e parashikuara në Kushtetutë, ka të drejtë të ankohet në Gjykatën e Lartë brenda 10 ditëve nga njoftimi i vendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Gjykimi i çështjes bëhet nga kolegjet e bashkuara.

KREU VI DISPOZITA TRANZITORE

Neni 47

Në rast shkrirjeje të një gjykate, në aktin përkatës të organit kompetent duhet të parashikohen edhe mundësitë e sistemimit të gjyqtarëve në vende të tjera të sistemit të drejtësisë.

Neni 48

(Shfuqizuar paragrafi I tretë me Vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 59, datë 5.11.1999)

Të gjithë gjyqtarët e shkallës së parë, që kanë punuar si gjyqtarë për më pak se 10 vjet, do t'i nënshtrohen një provimi kualifikimi profesional, teorik dhe praktik, me shkrim e me gojë.

Provimi do të organizohet nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës dhe Fakultetin Juridik të Universitetit të Tiranës. Ai do të mbahet jo më vonë se 1 qershori i vitit 1999.

Njoftimi për provimin dhe tematika që trajtohet do të botohen në dy gazetatat që kanë qarkullimin më të madh dhe do të afishohen në gjykata të paktën 6 muaj para çdo provimi. Këto modalitete respektohen edhe për nenin 20.

Ky provim mund të organizohet së bashku me çdo provim të parashikuar në nenin 20 të këtij ligji.

Dispozitë kalimtare
(Parashikuar me ligjin nr. 8656, datë 31.7.2000)

Koha e fillimit të veprimtarisë së gjykatave për krimet e rënda caktohet me ligj.

Neni 49

Ligji nr.8265, datë 18.12.1997 “Për Organizimin e Drejtësisë në Republikën e Shqipërisë” shfuqizohet.

Neni 50

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2292, datë 7.1.1999 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani**